



Në bazë të Nenit 8 të Ligjit të Punës (Ligji nr. 03/L-212), dhe Udhëzimin Administrativ (MFPT) Nr. 01/2024 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, neni 3, pika 1.2. neni 5 pika 2 dhe 5, N.P"Termokos" Sh.A në Prishtinë me datë: 24.04.2024 shpall:

## KONKURS TË BRENDSHËM

### PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË PUNËS

Titulli i pozitës: Zyrtar Ligjor - një (1) vend pune

Titulli i mbikëqyrësit: Udhëheqësi i Divizionit për Ndhmë Juridike

Kohëzgjatja e kontratës: Në afat të pacaktuar

Lartësia e pagës mujore: 808.64 euro

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Siguron mbikëqyrjen dhe harmonizimin e veprimtarisë së Ndërmarrjes me legjislacionin dhe standardet në fuqi;
- Ofron këshilla, opinione dhe rekomandime ligjore nga fushëveprimi i Ndërmarrjes, sipas kërkesës;
- Siguron respektimin e normave dhe standardeve ligjore në veprimtarinë e Ndërmarrjes;
- Ofron mbështetje ligjore në hartimin e dokumenteve strategjike dhe legjislative nga fushëveprimi i Ndërmarrjes;
- Ofron ndihmë në hartimin e legjislacionit nga fushëveprimi i Ndërmarrjes;
- Ofron ndihmë për strukturat organizative të Ndërmarrjes në identifikimin e çështjeve që duhet normuar;
- Ofron asistencë në harmonizimin e legjislacionit të Ndërmarrjes me legjislacionin primar dhe me normat tjera të aplikueshme në Kosovë;
- Identifikon problemet e zbatimit të akteve normative;
- Koordinon aktivitetet legjislative të Ndërmarrjes me institucionet përkatëse;
- Bën hulumtime dhe analiza të informatave në temat e caktuara nga KPSK dhe identifikon opsionet ose çështjet për shqyrtim;
- Kryen dhe punë tjera, të cilat delegohen nga menaxhmenti.

### Kualifikimet dhe përgatitja profesionale

- Bachelor/Fakulteti Juridik
- Tri (3) vite përvojë pune.
- Njohja e gjuhës angleze e preferuar.
- Përdorim profesional i produkteve të MS-office.
- Niveli i lartë të iniciativës, angazhimit, motivimit, vendosmërisë, intuitë dhe vemendje në detaje.
- Nivel të lartë i etikës profesionale.

Titulli i pozitës: Kontist financiar - një (1) vend pune

Titulli i mbikëqyrësit: Menaxherit të divizionit të kontabilitetit

Kohëzgjatja e kontratës: Në afat të pacaktuar

Lartësia e pagës mujore: 808.64 euro.

### Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Konton të gjithë dokumentacionin e kontabilitetit, pranon gjithë dokumentacionin (blerjeve, shpenzimeve, ditarin e arkës, llogaritë bankare, transferet bankare)
- Udhëheq në mënyrë sintetike dhe analitike kartela të veçanta sipas planit kontabël.
- Bënë përgatitjen e transferve bankare, për pagesa ndaj furnitorëve dhe institucioneve tjera.
- Dokumentacionin e pakompletuar e kthen në likuidaturën financiare për kompletim.
- Ndhmon në përpilimin e raporteve që kërkohen sipas dispozitave mbi kontabilitetin.
- Kontimin e transaksioneve financiare e bëjnë sipas Standardeve të Kontabilitetit.
- Bën barazimin ditore-mujor të karteleve sintetike me ato analitike.
- Urdhër kontimet e regjistruara në librin kryesor ditarin e punës dërgohen për verifikim te udhëheqësi të cilit i raporton.
- Përgatit raportet ditore, javore mujore dhe vjetore të regjistrimit.
- Ndhmon në raportet e barazimeve dhe informatave për udhëheqësin e shërbimit të financave.
- Mbi punën e kryer raporton në baza ditore, javore dhe mujore;
- Kryen edhe punët tjera të cilat delegohen nga Menaxhmenti;

### Kualifikimet dhe përgatitja profesionale

- Bachelor/ Fakulteti Ekonomik.
- Tri (3) vite përvojë pune në fushën përkatëse .
- Inovativ, orientuar drejtë zgjidhjes dhe mënyra e të menduarit nga optimizimi i procesit.

- Njohja e gjuhës angleze e dëshiruar .
- Përdorim profesional i produkteve të MS-office.
- Niveli i lartë të iniciativës, angazhimit, motivimit, vendosmërisë, intuitë dhe vemendje në detaje.
- Nivel të lartë i etikës profesionale.

**Titulli i pozitës: Koordinator për zhvillim të projekteve kapitale - një (1) vend pune**

**Titulli i mbikëqyrësit:** Drejtori i Departamentit për zhvillime dhe investime kapitale

**Kohëzgjatja e kontratës:** Në afat të pacaktuar

**Lartësia e pagës mujore:** 1101.10 euro.

#### Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Kujdeset për zhvillimin projekteve kapitale;
- Ofron dokumentacionin e kërkuar nga subjektet që kanë qasje në sistemin e Projekteve;
- Mbanë kontaktet dhe takimet me institucionet në interes të projektit,
- Në koordinim me Drejtorin ndërmerr hapat e duhur për projektet e ndërmarrjes
- Kryen të gjitha veprimet dhe punët të cilat lidhën me procesin e Projekteve;
- Mbi punën e kryer raporton në baza ditore, javore dhe mujore;
- Kryen edhe punët tjera të cilat delegohen nga Menaxhmenti.

#### Kualifikimet dhe përgatitja profesionale

- Bachelor/Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike apo Ekonomik.
- Tri (3) vite përvojë pune në fushën përkatëse.
- Njohje shumë të mirë të gjuhës angleze.
- Përdorim profesional i produkteve të MS-office.
- Niveli i lartë të iniciativës, angazhimit, motivimit, vendosmërisë, intuitë dhe vemendje në detaje.
- Nivel të lartë i etikës profesionale.

**Aplikantët e interesuar për vendet e punës duhet të bashkëngjisin këto dokumente:**

1. Aplikacionin e plotësuar;
2. CV e aplikantit;
3. Dëshminë e kualifikimit shkollor;
4. Dëshminë mbi përvojën e punës të dëshmuar me trust.
5. Dëshminë nga Gjykata kompetente që nuk është duke u zhvilluar procedurë penale ndaj tij/saj, jo më të vjetër se gjatë (6) muaj;
6. Dokumentin e identifikimit - letërnjoftimi i fotokopjuar.

7. Kopje të certifikatave, referencave tjera profesionale që ndërlidhën me pozitën që aplikoni.

**Mënyra e aplikimit:** Kandidatët mund ta shkarkojnë aplikacionin për punësim që gjendet në ueb faqen e Termokos [www.termokos.org](http://www.termokos.org);

Aplikacionet duhet të dorëzohen vetëm në mënyrë elektronike në emailin: [burimet.njerezore@termokos.org](mailto:burimet.njerezore@termokos.org),

Pas dërgimit të email-it ju do të pranoni konfirmimin nga ne. Nëse nuk keni pranuar konfirmimin, atëherë kontaktoni në nr. tel 038 541 - 780.

Konkursi i brendshëm do të jetë i hapur në afat prej 15 ditësh nga data e publikimit në tabelat e shpalljeve , në web faqe [www.termokos.org](http://www.termokos.org), dhe një gazetë online.

Mbyllja e konkursit bëhet më datë: 09.05.2024, ora 24.00.

**Vërejtje:** Pranohen vetëm dokumentacioni i punonjësve të Ndërmarrjes “Termokos” (sepse është konkurs i brendshëm).

Dokumentet e pa kompletuara, të pa skanuara si dhe ato që arrijnë pas afatit nuk do të shqyrtohen.

### **Mënyra e vlerësimit dhe kriteret e poentimit**

1. Vlerësimi i kandidatëve zhvillohet nëpërmjet testimit me shkrim dhe intervistimit;
2. Procedura e vlerësimit të konkursit të brendshëm përmban gjithsej 100 pikë, ku kalueshmerija është arritja e së paku pesëdhjetë e pesë (55) pikëve nga të gjitha fazat e konkursit;
3. CV i kandidatit vlerësohet deri në dhjetë (10) pikë;
4. Testi me shkrim deri në shtatëdhjetë (70) pikë;
5. Intervistimi deri në njëzetë (20) pikë.

**Kalendari i përafërt:** Bazuar në UA 01/2024 nenin 7 pika 1.11, procedura e rekrutimit të përafërt do të përfundojë brenda nëntëdhjetë (90) ditëve.